1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (4x 5)</b>
1.	Elemente bateri akumulatore plumb-acid 2V, 300 Ah për grupin 220 V, sipas specifikimeve	copë	110		
2.	Bazamente baterish për një grup bateri 220 V, sipas specifikimeve	komplet	1		
3.	Zbara lidhëse fleksibël bakri për një grup bateri 220 V	komplet	1		
4	Aksesorë – shirita (pllakëza Cu) lidhëse për terminalët e elementëve të baterive për një grup bateri 220 V	komplet	1		
5	Elemente bateri akumulatore plumb-acid 2V, 300 Ah për dy grupet 48 V, sipas specifikimeve	copë	50		
6	Bazamente baterish për dy grupet e baterive 48 V, sipas specifikimeve.	komplet	2		
7	Zbara lidhëse fleksibël bakri për dy grupet e baterive 48 V	komplet	2		
8	Aksesorë – shirita (pllakëza Cu)	komplet	2		

	lidhëse për terminalet e elementëve të baterive për dy grupet e baterive 48 V.				
9	Pajisjet dhe mjetet e shërbimit te baterive akumulatorë, sipas specifikimeve	komplet	1		
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					



---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-  
se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Objekti i prokurimit :

Furnizim instalim elemente bateri stacionare akumulatore acide, elemente 2VDC, 300Ah, per dy sallat 48V ne ndertesën e centralit dhe per nje salle 220VDC ne N/Stacionin 220kV, gjithsej 160 cope, me aksesoret perkates te montimit dhe instalimit, per HEC Fierzë.

#### A. Të dhënat teknike të elementeve akumulatorë të një grupi baterish 48 V

##### A.1 Të dhënat teknike të elementeve akumulatorë

Tensioni nominal i punës i grupit të baterive	48 V
Tensioni nominal i punës i çdo elementi akumulator	2V
Kapaciteti C 10 (Ah)	300 Ah
Numri i elementeve (akumulatoreve)	24 copë
Tensioni i lejuar në fund të karikimit manual	deri 2.7 V
Tensioni i lejuar i shkarkimit	deri 1.8 V
Densiteti i elektrolitit	D20°C/68°F = 1.24-1.26 kg/l
Afati i shërbimit	mbi 10 vjet

##### A.2 Te dhënat teknike të radrizzatorit të grupit të baterive 48 V

Tensioni normal në regjim floating	2.23 x 24	$U_F = 53.52 V$
Tensioni normal në regjim charge (boost)	2.4 x 24	$U_{CH} = 57.6 V$
Rryma nominale e radrizzatorit	$I_n = 100A$	

#### B. Të dhënat teknike të elementeve akumulatorë të një grupi baterish 220 V

##### B.1 Të dhënat teknike të elementeve akumulatorë

Tensioni nominal i punës i grupit të baterive	220 V
Tensioni nominal i punës i çdo elementi akumulator	2V
Kapaciteti C 10(Ah)	300 Ah
Numri i elementeve (akumulatoreve)	110 copë
Tensioni i lejuar në fund të karikimit manual	deri 2.7 V

Tensioni i lejuar i shkarkimit	deri 1.8 V
Densiteti i elektrolitit	D20°C/68°F = 1.24-1,26 kg/l
Afati i shërbimit	mbi 10 vjet

## B.2 Te dhenat teknike të radrizatorit të grupit të baterive 220 V

Tensioni normal në regjim floating	2.23 x 110	$U_F = 245.3 \text{ V}$
Tensioni normal në regjim charge (boost)	2.4 x 110	$U_{CH} = 264 \text{ V}$
Rryma nominale e radrizatorit	$I_n = 150 \text{ A}$	

## C. Detyrat e furnizim vendosjes se kontraktorit.

### 1. Kontraktori në këtë objekt prokurimi kërkohet që të furnizojë :

- 50 elementet e baterive akumulatore sipas specifikimeve per dy grupet 48V ne ndertesën e centralit, shoqeruar me aksesoret e montimit në vend të rekomanduar nga prodhuesi dhe gjithë zbara lidhëset fleksibile bakri për lidhjen elektrike ndërmjet rreshtave të dy grupeve të baterive 48VDC, shiritat (pllakëzat) lidhëse për terminalet e elementeve akumulatore të baterive.

- 110 elementet e baterive akumulatore sipas specifikimeve per grupin e baterive 220V DC ne N/Stacionin 220kV Fierze, shoqeruar me aksesoret e montimit në vend të rekomanduar nga prodhuesi dhe gjithë zbara lidhëset fleksibël bakri për lidhjen elektrike ndërmjet rreshtave të grupit të baterive 220V DC, shiritat (pllakëzat) lidhëse për terminalet e elementeve të baterive akumulatore.

### 2. Kontraktori në këtë objekt prokurimi kërkohet që të vendose/instaloje:

Pas furnizimit ne HEC Fierze sipas destinacioneve perkatese kontraktori do të beje :

- Vendosjen në vendmontimin ekzistues (bashke me bazamentet e reja) dhe instalimin e 48 elementeve akumulatore (24 elemente per secilin grup 48VDC) në skemen elektrike të karikimit të baterive ekzistuese të të dy grupeve 48 V DC (2 elemente do te qendrojne rezerve ne sallën e baterive per mirembajtje).

- Vendosjen në vendmontimin ekzistues (bashke me bazamentet e reja) dhe instalimin e 110 elementeve akumulatore në skemen elektrike të karikimit të baterive ekzistuese të grupit 220 V DC ne N/Stacionin 220kV Fierze.

- Pas demontimit te baterive te vjetra, kontraktori duhet ti dorëzojë në magazinën e rikuperave të HEC Fierze. Marrja në dorëzim e baterive të demontuara nga kontraktori do të bëhet me një akt të veçantë në të cilin do të përshkruhen në mënyre të detajuar me inventarë të rregullt numrin e elementeve te baterive të grupeve 48V dhe të grupit 220V, zbaralidhësat fleksibël të rreshtave dhe aksesorët e tjerë.

## D. Kërkesat teknike per baterite dhe aksesoret e montimit/instalimit.

1. Akumulatoret duhet të kenë të shënuar në trupin e baterisë nivelin e elektrolitit (minimal.mesatar,maksimal ) dhe në terminale duhet të jete i shenuar qartë polariteti i tyre.

2. Elementet e baterive akumulatore plumb – acid duhet të jenë të mbyllur në **enë polikarbonati transparent** dhe të paisur me valvol për shfryrjen e gazrave. Paisja e elementeve të baterive akumulatore plumb – acid

---

me valvol për shfryrjen e gazrave është e domosdoshme për të shmangur eksplozimin e baterive akumulatore në raste aksidentesh. Elementet e baterive akumulatore plumb – acid duhet të kenë dy terminale (dalje) një për polin pozitiv dhe një për polin negativ për lidhje me bullon M10.

**3.** Bateritë akumulatore duhet të shoqerohen me instruksion shfrytëzimi dhe mirëmbajtje në gjuhën angleze. Në instruksion të jete pershkruar menyra e ndërtimit të akumulatoreve, karakteristika e tensionit të floatimit, të ngarkimit, të shkarkimit, të dhena të densitetit të elektrolitit sipas proceseve të mësipërme si dhe cdo e dhënë tjetër që zotëron prodhuesi.

Në këtë instruksion apo manual të jepet dhe afati i shërbimit të baterive akumulatore, i cili duhet të jete mbi 10 vjet. Meqense bateritë që kërkohen të furnizohen për HEC Fierzë, klasifikohen në grupin e baterive me performancë të lartë dhe afat shërbimi 10-12 vjet, nga uzina prodhuese e baterive duhet të tregohet se cila metodë e dizenjimit të jetëgjatësisë të baterive është përcaktuese, dhe të siguroje një evidencë për përdoruesin (HEC-in Fierzë).

**4.** Broshurat teknike të baterive të ofertuara duhet të jenë të aksesueshme në internet në websiten e prodhuesit të baterive, kjo për të mundësuar komisionin e vlerësimit të ofertave të vërtetojnë përpuethshmërinë e baterive të ofruara me specifikimet teknike të kërkuara.

**5.** Kontraktori mbas nënshkrimit të kontratës dhe përpara fillimit të punës apo përpara fillimit të porosisë për prodhimin e bazamenteve të baterive ka për detyrë të shkojë për vizitë në HEC Fierzë tek sallat e baterive të bëjë investigime apo matje të nevojshme në funksion të projektimit të bazamenteve të baterive për të minimizuar në maksimum mospëputhshmëritë dhe për të realizuar me sukses projektimin e bazamenteve të rinj të shkallëzuar, ku do të montohet grupi i baterive 220V dhe dy grupet e baterive 48V. Bazamentet metalike duhet të dizenjohen dhe të prodhohen me profil “L” ose “H”, në menyre që të lejojnë (të mos pengojnë) kontrollin vizual të pjesës së fundit të baterisë. Bazamentet metalike të baterive duhet të jene të xinkuara në të nxehte ose të lyhen me nje dore bojë antiruzh (antindryshk) dhe me dy duar bojë të zezë rezistente ndaj acideve. Konstruksioni i bazamenteve metalike të baterive duhet të fiksohet në mënyrë solide me dyshtemënë. Është detyrë e kontraktorit që mbas montimit të bazamenteve të reja metalike të realizojë tokëzimin e këtyre bazamenteve dhe lidhjen e tyre me tokëzimin ekzistues të HEC Fierzë (tokëzimin e sallës së baterive). Tokëzimi i bazamenteve do të realizohet me përcjelles bakri të veshur me seksion  $S=25\text{mm}^2$ . Në figurën e mëposhtme jepet modeli në mënyrë ilustruese se si do të prodhohen bazamentet metalike të shkallëzuara (stolat) për katër grupet e baterive.



Pamje ilustruese e bazamentit të baterive

## **6. Paisjet dhe mjetet e shërbimit te baterive akumulatorë, pjese e furnizimit:**

**A.** Set me hidrometër dhe termometër

---

Hidrometer i cili bën të mundur matjen e dendësisë së elektrolitit brenda akumulatorëve të plumbit. Hidrometri duhet të jetë i testuar dhe i prodhuar nga kompania prodhuese e baterive me qëllim që funksionimi i tij të përputhet 100% me bateritë të cilat operatorët do të ofrojnë. Pompa thithëse duhet të jetë prej gome ndërkohë që pjesa kryesore e shiringës duhet të jetë prej xhami. Gryka dhe terminali duhet të jenë PVC. Hidrometri duhet të ketë matje të shkallëzuar dhe të jetë i aftë të masë dendësinë minimumi nga 1,080-1,3 g/cm<sup>3</sup> dhe 10-35 B<sup>e</sup>. Saktësia e matjes së hidrometrit të jetë maksimumi ±0.01 g/m<sup>3</sup>. Pajisja duhet të jetë konform standarteve ISO 387, ISO 649-1 dhe ISO 649-2 ose ekuivalente me këto standarte.

Termometri duhet të jetë me strukture xhami dhe të mund të masë temperaturat nga -10<sup>o</sup>C deri në 70<sup>o</sup>C me ndarje Jo më të mëdha se 1<sup>o</sup>C.

Në përbërje të setit duhet të jetë edhe një pipetë plastike e cila ndihmon në marrjen e elektrolitit në akumulatorët e plumbit. Kjo pipetë të jetë e përshtatshme me hidrometrin dhe me gjatësi minimalisht 150 mm.

**B.** Vazelinë për ruajtjen e kontakteve dhe terminaleve nga oksidimi. Vazelina duhet të jetë e gradës farmaceutike dhe të jetë në përputhje me standartet e BE. Vazelina të jetë në formë paste dhe pa ngjyrë. Dendësia 0.86-0.87 g/cm<sup>3</sup> në 15<sup>o</sup>C. Pika e shkrirjes të jetë më e lartë se 50<sup>o</sup>C dhe viskoziteti 3-30mm<sup>2</sup>/s në 100<sup>o</sup>C. Vazelina nuk duhet të ketë përbajtje toksike.

**C.** Seti për shpëlarjen e syve, që vendosen në vendet e caktuara të dhomës së baterive, për përdorim në raste emergjence. Seti për shpëlarjen e syve të jetë në formë lëngu, pa ngjyrë dhe pa aromë i përshtatshëm në rast kontaminimi me tretësirë acide. Të jetë me pH 7.1-7.7 dhe me temperaturë vlimi më të lartë se 95<sup>o</sup>C. Dendësia e tij të jetë 1.03-1.04 g/cm<sup>3</sup>. Të ketë në përbërje të tij uje, fosfat, disodium dhe fosfat potasiumi. Të jetë në përputhje me standartet e BE dhe EN 15154-4. Shishja ku mbahet solucioni duhet të jetë e përshtatshme për shpëlarjen e të dy syve në të njëjtën kohe. Sasia e lëngut për çdo paketim të jetë të paktën 200 ml.

#### **Dokumentacioni teknik shoqërues.**

Bateritë e furnizuara dhe montuara në sallat e baterive të HEC Fierzë, duhet të shoqërohen me dokumentacionin teknik si më poshtë:

1. Manualin e instalimit operimit dhe të mirëmbajtjes për bateritë stacionare plumb-acid në gjuhën Angleze.
2. Testet dhe kontrollët në fabrikë të baterive në përputhje me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë të çertifikuar sipas standartit European DIN EN ISO 9001:2000.
3. Test raportet në fabrikë të baterive për kapacitetin (Capacity test) sipas standartit ndërkombëtar IEC 60896-11.
4. Çertifikatën/Deklaratën e konformitetit CE.
5. Çertifikatën e cilësisë së prodhuesit.

**Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

1	2	3	4
Nr	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia
1	Elemente bateri akumulatore plumb-acid 2V, 300 Ah për grupin 220 V, sipas specifikimeve.	copë	110
2	Bazamente baterish për një grup bateri 220 V, sipas specifikimeve.	komplet	1
3	Zbara lidhëse fleksibël bakri për një grup bateri 220 V.	komplet	1
4	Aksesorë – shirita (pllakëza Cu) lidhëse për terminalet e elementëve të baterive për për një grup bateri 220 V	komplet	1
5	Elemente bateri akumulatore plumb-acid 2V, 300 Ah për dy grupet 48 V, sipas specifikimeve.	copë	50
6	Bazamente baterish për dy grupet e baterive 48 V, sipas specifikimeve.	komplet	2
7	Zbara lidhëse fleksibël bakri për dy grupet e baterive 48 V	komplet	2
8	Aksesorë – shirita (pllakëza Cu) lidhëse për terminalet e elementëve të baterive për dy grupet e baterive 48 V.	komplet	2
9	Paisjet dhe mjetet e shërbimit të baterive akumulatorë, sipas specifikimeve	komplet	1

#### Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1-9	Në përputhje me zërat e përcaktuara në formularin e ofertës		KESH sh.a – Njesia e Prodhimit HEC Fierzë	6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e kontrates

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.



---

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

---

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:** Bazuar sa më sipër.

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore ose bilancet për vitet financiare (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 18,000,000 (Tetëmbëdhjetë milion) Lekë.

#### 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 7,300,000 (Shtatë milion e treqind mijë) Lekë.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të kete në stafin e tij 1 (një) Inxhinier Elektrik dhe 1 (një) Inxhinier Mekanik.

#### **Për të provuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet:**

- Diplomën e Inxhinierëve
- Kontratë Punë të Vlefshme
- CV
- Listëpagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore sipas formularit E/Sig -25, per periudhën Prill 2021- Qershor 2021.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, të cilat duhet të perkojnë me kategorinë dhe specifikën e produkteve që prokurohen, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si me poshte:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- b) ISO 18001:2007 / 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”
- c) ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”

---

#### **2.3.4** Operatori Ekonomik **për bateritë e ofruara** duhet të paraqesë:

- ✚ Autorizim prodhuesi ose distributori. *Në autorizimin e prodhuesit duhet të jenë të shënuar të dhënat e sakta si: numri i telefonit të prodhuesi, adresë e-mail, në rast verifikimi nga ana e Autoritetit Kontraktor. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm ( kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*
- ✚ Katalogun/ët teknik të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat për bateritë dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. *Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme bateritë e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*
- ✚ Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për bateritë të lëshuara nga institucione të autorizuara me ligj ose nga prodhuesi të kryera më parë (nese mallrat e ofruara jane subjekt i testimeve), që të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara, me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.
- ✚ Deklaratën e konformitetit CE të produkteve të ofertuara nga prodhuesi (nese keto mallra jane subjekt i certifikimit CE).

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi se afati i shërbimit për bateritë do të jetë në përputhje me afatin e përcaktuar në specifikimet teknike.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të disponojë Certifikatën që vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit/ve të jetë sipas standartit ISO 9001:2015 e përshtatshme për objektin e prokurimit.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

**2.3.8** Operatori ekonomik ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostren për 1 njësi qelize (një element) të mallit që ofron.

*Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën dhe orën e hapjes së tenderit para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet ta bëjë shoqërimin e tyre me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat e paraqitura. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shenim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

## Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p>	<p>Po [ ]</p>

<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>



<p>ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
